



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 713/2017**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.10.2017 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të BOE “LEL” sh.p.k & “KAZAZI-MEAT” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt “Blerje Ushqimesh”, me nr. REF-24608-08-24-2017, me fond limit 35,333,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 25.09.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “MB KURTI” sh.p.k., si dhe shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertave të operatorëve të tjerë ekonomik pjesëmarrës, për procedurën e sipërcituar.

**Ankimues:**

BOE “NELSA” sh.p.k. & “ERDIS” sh.p.k,  
Adresa: Qesarakë, Tiranë.

Operatori ekonomik “M.B KURTI” sh.p.k.  
Adresa: Lagjia “Xhevdet Nepravishta”, Rruga “Iliaz Ahmeti”,  
magazinë 1 katëshe, pranë Fabrikës së Qumështit, Lushnje.

**Autoriteti kontraktor:**

Bashkia Durrës.  
Adresa: Sheshi “LIRIA” Durrës.

**Baza Ligjore:**

*Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1.Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Gjithashut, KPP konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2.Operatorët ekonomik ankimues kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. BOE “NELSA” sh.p.k. & “ERDIS” sh.p.k ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik..

I.4. Operatori ekonomik “MB KURTI” sh.p.k. nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Autoritetit Kontraktor.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1.Në datën 25.08.2017 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt “Blerje Ushqimesh”, me nr. REF-24608-08-24-2017, me fond limit 35,333,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 25.09.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 25.09.2017 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3.Në datën 28.09.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. ”MB KURTI” sh.p.k.	26,500,000 lekë pa tvsh	skualifikuar;
2. ”LEL” sh.p.k. & ”KAZAZI-MEAT” sh.p.k.	28,318,850 lekë pa tvsh	kualifikuar;
3. ”NELSA” sh.p.k. & ”ERDIS” sh.p.k.	33,296,150 lekë pa tvsh	kualifikuar;

II.4.Në datën 03.10.2017 BOE ankimues “NELSA” sh.p.k. & “ERDIS” sh.p.k ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës të BOE “LEL” sh.p.k & “KAZAZI-MEAT” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

*“[...]Nga shume dokumenta te cilat jane anashkaluar nga KVO-ja, po ju theksojme se ne dokumentat e ketij Operatori ka mangesi te theksuara per te cilat po permendim vetem nje pjese e vogel te tyre:*

*1.Ne dst thuhet qe operoret ekonomik te dorzojne Certifikatat: Sistemi manaxhimit te cilesise (ISO 9001) Çertifikat: Sistemi manaxhimit te mjedisit (ISO 14001) Çertifikat: Sistemi manaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune (OHSAS-18001), Çertifikat: Sistemi i manaxhimit te sigurise ushqimore ISO 22000, Çertifikat: Sistemi manaxhimit te HACCP. Ne rast bashkimi te operatoreve ekonomik, cdo operator pjesemarres duhet te paraqesi çertifikatat ISO te lartpermendura. Kjo kerkese nuk eshte plotesuar nga ky operator pasi nuk jane dorzuar te gjitha certifikatat sic kerkohen ne dst.*

*2.Kontrata me nr 27/1 date 12.01.2016 per furre buke me subjektin “Andon Zhidro”, Elbasan eshte e pa zyrtarizuar e cila te tregoje qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit. (e panoterizuar) Kjo kerkese nuk eshte plotesuar nga ky operator.*

*3. Operatori ekonomik “Kazazi” shpk per pervoje te ngjashme ka paraqitur vetem fatura tatimore shitje vetem mish pa firma te shitesit dhe maresit te mallit ne dorezim, dhe shumica e tyre jane te palexueshme.*

*4. Kontraten e dorezuar nga Operatori ekonomik “Lel” shpk me Spitalin Rajonal Shkoder eshte me bashkim operatoresh, ku % me te madhe rreth 70-80% e ka shoqeria “Erdis” shpk, keshtu kjo kontrate nuk mund te meret parasysh vetem per llogari te shoqerise “Lel” shpk.*

*Perveç ketyre mangesive kjo shoqeri ka dhe probleme te tjera ne dokumentacionin e dorezuar per llogari te ketij tenderi, te cilat duhen te shikohen me kujdes nga ana e KVO-se. [...]*


II.4.1.Në datë 04.10.2017 autoriteti kontraktor i kthen përgjigje operatorit ekonomik ankimues BOE ankimues “NELSA” sh.p.k. & “ERDIS” sh.p.k, me anë të shkresës Nr. 7726/2 Prot. datë 04.10.2017, duke mos e pranuar ankesën e tij për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5.Në datën 09.10.2017 pala ankimuese “NELSA” sh.p.k. & “ERDIS” sh.p.k, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6.Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “MB KURTI” sh.p.k., referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues “MB KURTI” sh.p.k., ky i fundit pretendon se në datën 04.10.2017, ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor me anë të të cilit kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij, ankim i cili referuar aktit të trajtimit të ankesës nga autoriteti kontraktor me nr.7788/4prot., datë 11.10.2017, është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor në datën 06.10.2017.

II.7.Në datën 23.10.2017, operatori ekonomik “MB KURTI” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8.Në datën 18.10.2017 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.17871/1prot., datë 12.10.2017, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.



### **III Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesave dhe dokumentacionit bashkëngjitur tyre

#### **Arsyeton**

III.1.Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “NELSA” sh.p.k. & “ERDIS” sh.p.k mbi kualifikimin e ofertës të BOE “LEL” sh.p.k & “KAZAZI-MEAT” sh.p.k, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, me argumentin se *“1.Ne dst thuhet qe operoret ekonomik te dorzojne Certifikatat: Sistemi manaxhimit te cilesise (ISO 9001) Çertifikat: Sistemi manaxhimit te mjedisit (ISO 14001) Çertifikat: Sistemi manaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune (OHSAS-18001), Çertifikat: Sistemi i manaxhimit te sigurise ushqimore ISO 22000, Çertifikat: Sistemi manaxhimit te HACCP. Ne rast bashkimi te operatoreve ekonomik, cdo operator pjesemarres duhet te paraqesi çertifikatat ISO te lartpermendura. Kjo kerkese nuk eshte plotesuar nga ky operator pasi nuk jane dorzuar te gjitha certifikatat sic kerkohen ne dst.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në pikën 2.3 gërma 1, të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“1. Çertifikatat:

- Çertifikat: Sistemi manaxhimit te cilesise (ISO 9001)
- Çertifikat: Sistemi manaxhimit te mjedisit (ISO 14001)
- Çertifikat: Sistemi manaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune (OHSAS-18001)
- Çertifikat: Sistemi i manaxhimit te sigurise ushqimore ISO 22000
- Çertifikat: Sistemi manaxhimit te HACCP

Ne rast bashkimi te operatoreve ekonomik, cdo operator pjesemarres duhet te paraqesi çertifikatat ISO te lartpermendura.”

III.1.2. Nga verifikimi i kryer nga KPP, për plotësimin e kriterëve të mësipërme, operatori ekonomik pjesëtar i bashkimit të operatorëve “LEL” sh.p.k. ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.):

1. Certifikatë ISO 9001:2008, në gjuhën angleze, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.
2. Certifikatë ISO 14001:2004, në gjuhën angleze, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.
3. Certifikatë BS OHSAS 18001:2007, në gjuhën angleze, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar
4. Certifikatë ISO 22000:2005, në gjuhën angleze, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar
5. Certifikatë ISO HACCP, në gjuhën angleze, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar

III.1.3. Nga verifikimi i kryer nga KPP, për plotësimin e kriterëve të mësipërme, operatori ekonomik pjesëtar i bashkimit të operatorëve “KAZAZI-MEAT” sh.p.k. ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.):

1. Certifikatë ISO 9001:2008, në gjuhën angleze, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.
2. Certifikatë ISO 14001:2004, në gjuhën angleze, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.
3. Certifikatë BS OHSAS 18001:2007, në gjuhën angleze, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar
4. Certifikatë ISO 22000:2005, në gjuhën angleze, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar
5. Certifikatë UNI 10854:1999 (HACCP), në gjuhën angleze, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar

III.1.4. Në nenin 46, pika 2 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti

*kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: 2. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. [...]*”

III.1.5. Në nenin 30 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”

III.1.6. Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

III.1.7. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në plotësim të kriterit të sipërcituar, KPP konstaton se të dy operatorët ekonomik pjesëtarë të bashkimit BOE “LEL” sh.p.k & “KAZAZI-MEAT” sh.p.k, kanë paraqitur të gjitha certifikatat e subjekteve të tyre për përmbushjen e standarteve, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3 gërma 1, të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i mësipërm i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “NELSA” sh.p.k. & “ERDIS” sh.p.k mbi kualifikimin e ofertës të BOE “LEL” sh.p.k & “KAZAZI-MEAT” sh.p.k, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, me argumentin se “2. Kontrata me nr 27/1 date 12.01.2016 per furre buke me subjektin “Andon Zhidro”, Elbasan eshte e pa zyrtarizuar e cila te tregoje qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit. (e panoterizuar) Kjo kerkese nuk eshte plotesuar nga ky operator.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në pikën 2.3 gërma m, të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon: “Furre buke ne pronesi/perdorim e pajisur me: leje higjeno sanitare; Leje mjedisore; License leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKB).

*Per produktin e mesiperme ne rastin kur operatori nuk e ka ne pronesi/perdorim duhet qe te vertetoje me marreveshje bashkepunimi te zyrtarizuar e cila te tregojte qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet te permbaje te dhena te plota si: license, telefon, e-mail,  ebsite, etj., kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi.”*

III.2.2. Nga verifikimi i kryer nga KPP, p r plot simin e kriterëve t  m sip rme, operatori ekonomik pjes tar i bashkimit t  operator ve “LEL” sh.p.k. ka dor zuar n  Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.):

1.Kontrat  furnizimi nr.23, dat  10.04.2017 lidhur nd rmjet shoq ris  “LEL” shpk (bler s) dhe subjektit “Andon Zhidro” (furnizues), me objekt “Blerja e produkteve t  brumit (Buk )”.

III.2.3. N  nenin 46, t  LPP-s  parashikohet se: *“Operator t ekonomik , p r t  marr  pjes  n  procedurat e prokurimit, duhet t  kualifikohen, pasi t  ken  p rmbushur t  gjitha kriteret q  autoriteti kontraktor i vler son t  nevojshme, p r sa koh  q  ato jan  n  p rpjestim me natyr n dhe p rmasat e kontrat s q  do t  prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.2.4. N  nenin 53, pika 1 t  LPP-s  parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor, kur e shikon t  arsyeshme, u k rkon ofertuesve sqarime p r ofertat e tyre, p r shqyrtimin, vler simin dhe krahasimin sa m  t  drejt  t  k tyre ofertave. ...”*

III.2.5. Kriteret p r kualifikim vendosen q  ti sh rbejn  autoritetit kontraktor p r njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve t  operator ve ekonomik , t  cil t, n p rmjet dokumentacionit t  paraqitur duhet t  v rtetojn  se zot rojn  kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerit , pajisjet e asete t  tjera fizike, reputacionin dhe besueshm rin , p rvoj n e duhur, si dhe personelin e nevojsh m, gjith ka n  funksion t  realizimit me sukses t  kontrat s. N  k t  kuptim, p r Autoritetin Kontraktor  sht  e r nd sishme t  provohet q  operatori ekonomik zot ron kapacitetin teknik, e konkretisht t  ket  n  pronesi/p rdorim furr  buke ose marr veshje furnizimi me n j  subjekt q  disponon furr  buke, n  m nyr  q  t  p rmbush me sukses kontrat n p r furnizimin me mallrat objekt prokurimi. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues se kontrata e furnizimit, e lidhur nd rmjet shoq ris  “LEL” sh.p.k (bler s) dhe subjektit “Andon Zhidro” (furnizues), me objekt “Blerja e produkteve t  brumit (Buk )” nuk  sht  e zyrtarizuar (e panoterizuar), KPP v ren se autoriteti kontraktor n  kriterin e vendosur n  pik n 2.3 g rma 1, t  shtojc s 8, “Kapaciteti teknik”, n  dokumentat standarte t  tenderit t  procedur s s  prokurimit objekt ankimi, nuk e ka specifikuar qart  form n e zyrtarizimit dhe form n e dokumentacionit p r t  p rmbushur kriterin e sip rcituar n  p rputhje me nenin 28 pika 2, t  VKM nr. 914, dat  29.12.2014 “P r Miratimin e Rregullave t  Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: *K rkesat e ve anta t  kualifikimit duhet t  p rfshijn  t  gjitha kriteret specifike, n  p rputhje me nenin 46 t  LPP. Kriteret duhet t  jen  n  p rpjes tim dhe t  lidhura ngusht  me aft sin  zbatuese, natyr n dhe vler n e kontrat s. N   do rast, autoriteti kontraktor duhet t  p rcaktoj  dokumentet konkrete q  duhet t  paraqesin operator t ekonomik  p r p rmbushjen e k tyre kriterëve.”* KPP gjykon se togfjal shi

*“marrëveshje bashkëpunimi e zyrtarizuar”*, jo domosdoshmërisht do të thotë marrëveshje e noterizuar. KPP sqaron se, kontrata e furnizimit është një marrëdhënie e krijuar ndërmjet palëve, në rastin konkret ndërmjet shoqërisë “LEL” sh.p.k. dhe subjektit “Andon Zhidro” me vullnetin e tyre të lirë, për realizimin e e furnizimeve, si dhe një marrëdhënie e pavaruar që nuk ndikohet nga kushtet e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor. Kontrata e lidhur ndërmjet tyre është një veprim juridik, që referuar Kodit Civil, është *“shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile”*. Kontrata e lidhur mes palëve është një veprimtari apo marrëdhënie dypalëshe, e cila mund të jetë edhe e ndryshueshme në kohë. Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit, operatori ekonomik të vërtetojë se disponon kapacitete në lidhje me eksperiencat e mëparshme, makineritë e pajisjet, kapacitetet organizative, pajisjet e asete të tjera fizike etj., duke realizuar edhe qëllimin e vendosjes së këtyre kriterëve, për të kualifikuar një shoqëri që plotëson të gjitha kriteret dhe kërkesat e autoritetit kontraktor. Pavarësisht nga konfuzioni i krijuar nga togfjalëshi *“marrëveshje bashkëpunimi e zyrtarizuar”*, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor në asnjë rast gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk ka gjykuar të arsyeshme kërkimin e sqarimeve për operatorin ekonomik ankimues në lidhje me pretendimin e ngritur sa më lart dhe e ka pranuar si të vlefshëm dokumentin e kontestuar nga BOE ankimues. Në këto kushte, K.P.P. gjykon se përsa kohë kontrata e furnizimit e sipërcituar, plotëson kushtet ligjore të përcaktuara në Kodin Civil të RSH-së për tu konsideruar e vlefshme, BOE “LEL” sh.p.k & “KAZAZI-MEAT” sh.p.k e ka plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i mësipërm i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3.Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “NELSA” sh.p.k. & “ERDIS” sh.p.k mbi kualifikimin e ofertës të BOE “LEL” sh.p.k & “KAZAZI-MEAT” sh.p.k, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, me argumentin se *“3. Operatori ekonomik “Kazazi” shpk per pervoje te ngjashme ka paraqitur vetem fatura tatimore shitje vetem mish pa firma te shitesit dhe maresit te mallit ne dorezim, dhe shumica e tyre jane te palexueshme.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1.Në pikën 2.3 gërma g, të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

*“Pervoje e mepareshme, të ngjashme, në një vlerë prej 14’000’000 lekë, të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit; Dëshmitë për furnizimin e mallrave duhet të jepen përmes Kontrates/Kontratave te shoqeruara me faturen/faturat tatimore dhe vërtetim të marrësit të mallit, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisitë e mallrave të furnizuara.”*

III.3.2. Nga verifikimi i kryer nga KPP, për plotësimin e kriterëve të mësipërme, operatori ekonomik pjesëtar i bashkimit të operatorëve “KAZAZI-MEAT” sh.p.k. ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.):



1. Kontratë furnizimi dhe shërbimi lidhur ndërmjet shoqatës “ISLAMIC RELIEF-ALBANIA” (porositës) dhe shoqërisë “KAZAZI-MEAT” sh.p.k. (i porositur), me objekt “Blerje mish vici të freskët”, shoqëruar me 9 (nëntë) faturat tatimore të shitjes përkatëse.
2. Akt-marrëveshje furnizimi dhe shërbimi lidhur ndërmjet shoqatës “Qatar Charity” (porositës) dhe shoqërisë “KAZAZI-MEAT” sh.p.k. (i porositur), me objekt “Blerje mish vici”, shoqëruar me 6 (gjashtë) faturat tatimore të shitjes përkatëse.

III.3.3. Në nenin 46, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese[...]

III.3.4. Në nenin 27, pika 4 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

III.3.5. Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

III.3.6. Lidhur me pretendimin e BOE ankimes, që operatori ekonomik pjesëtar i bashkimit të operatorëve “KAZAZI-MEAT” sh.p.k., ka paraqitur fatura tatimore shitje vetëm mish, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar, KPP konstaton se BOE “LEL” sh.p.k & “KAZAZI-MEAT” sh.p.k, ka paraqitur kontratën e bashkëpunimit nr.2381rep., nr.765kol, lidhur ndërmjet shoqërisë “LEL” sh.p.k dhe shoqërisë “KAZAZI-MEAT” sh.p.k, në të cilën konstatohet se operatori ekonomik pjesëtar i bashkimit të operatorëve “KAZAZI-MEAT” sh.p.k., për procedurën objekt shqyrtimi, ka marrë përsipër të kryej furnizime vetëm për mish dhe produktet e mishit. KPP thekson se në rastet e paraqitjes së ofertave nga një bashkim operatorësh ekonomik, detyrimi për të vërtetuar furnizime të ngjashme për tre vitet e fundit, për secilin operator është sipas zërave të furnizimit dhe përqindjes në pjesëmarrje që gjithsecili ka marrë përsipër nëpërmjet kontratës së bashkëpunimit, kjo bazuar në nenin 74 pika 3 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”, të ndryshuar në të cilin parashikohet se: *“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në këto kushte, KPP gjykon se paraqitja nga ana e operatorit ekonomik pjesëtar i bashkimit të operatorëve “KAZAZI-MEAT” sh.p.k., e kontratave të ngjashme vetëm për furnizime me mish dhe produkte mishi, është e mjaftueshme për të plotësuar pjesën e tij në përmbushje të kriterit të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor në pikën 2.3 gërma g, të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Ndërsa lidhur me pretendimet mbi palexueshmërinë e disa prej faturave tatimore të shitjes ose pamundësia për të dalluar nëse ato janë të nënshkruara, KPP vëren se në të dy rastet ky problem ka ardhur si rrjedhojë e skanimit të dokumentacionit. Gjithsesi, KPP sqaron se autoriteti kontraktor disponon tagrat dhe mjetet ligjore për të kërkuar nga operatorët ekonomik sqarime mbi dokumentacionin e paqartë të dorëzuar në mënyrë elektronike nga ana e tyre, pasi ka në dispozicion momentin procedural të parashikuar nga neni 53 pika 1 e LPP-së në të cilin parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, K.P.P. vëren se autoriteti kontraktor në asnjë rast gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk ka gjykuar të arsyeshme kërkimin e sqarimeve për operatorin ekonomik ankimues në lidhje me pretendimin e ngritur sa më lart. Në kushte, KPP gjykon se ka qënë në diskrecion të autoritetit kontraktor që të verifikojë dhe të kërkojë sqarime lidhur dokumentacionin e kontestuar nga BOE ankimues dhe përsakohë autoriteti kontraktor i ka pranuar si dokumenta të rregullta faturat tatimore të shitjes, në mungesë të mjeteve ligjore për të kryer verifikimet e nevojshme, KPP nuk do të marrë në shqyrtim këtë pretendim.*

Sa më sipër, pretendimi i mësipërm i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “NELSA” sh.p.k. & “ERDIS” sh.p.k mbi kualifikimin e ofertës të BOE “LEL” sh.p.k & “KAZAZI-MEAT” sh.p.k, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, me argumentin se *“4. Kontraten e dorëzuar nga Operatori ekonomik “Lel” shpk me Spitalin Rajonal Shkoder eshte me bashkim operatoresh, ku % me te madhe rreth 70-80% e ka shoqeria “Erdis” shpk, keshtu kjo kontrate nuk mund te meret parasysht vetem per llogari te shoqerise “Lel” shpk.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në pikën 2.3 gërma g, të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon: *“Pervoje e mepareshme, të ngjashme, në një vlerë prej 14’000’000 lekë, të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit; Dëshmitë për furnizimin e mallrave duhet të jepen përmes*

*Kontrates/Kontratave te shoqeruara me faturen/faturat tatimore dhe vërtetim të marrësit të mallit, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.”*

III.4.2. Nga verifikimi i kryer nga KPP, për plotësimin e kriterëve të mësipërme, operatori ekonomik pjesëtar i bashkimit të operatoëve “LEL” sh.p.k., ndër të tjera ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.):

1. Kontratë lidhur ndërmjet Spitalit Rajonal Shkodër dhe BOE “LEL” sh.p.k. & “ERDIS” sh.p.k., me objekt “Blerje ushqimesh bylmet mish fruta bukë”, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

III.4.3. Në nenin 46, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese[...]

III.4.4. Në nenin 27, pika 4 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.”

III.4.5. Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

III.4.6. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues, se kontrata e sipërcituar nuk mund të merret parasysh vetëm për llogari të operatorit ekonomik pjesëtar i bashkimit të operatorëve “LEL” sh.p.k., pasi përqindjen më të madhe e ka realizuar shoqëria “ERDIS” sh.p.k, KPP vëren se në dokumentacionin e dorëzuar në mënyrë elektronike nga BOE “LEL” sh.p.k & “KAZAZI-MEAT” sh.p.k, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, në asnjë rast nuk specifikohet përqindja në pjesëmarrje e secilit prej operatorëve në realizimin e kontratës lidhur ndërmjet Spitalit Rajonal Shkodër dhe BOE “LEL” sh.p.k. & “ERDIS” sh.p.k., me objekt “Blerje ushqimesh bylmet mish fruta bukë”. Në këto kushte, KPP gjykon se BOE ankimues në parashtrimet me shkrim dorëzuar pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në asnjë rast nuk ka sqaruar, argumentuar, si dhe të mbështesë me fakte dhe prova pretendimet e tij. K.P.P gjykon se

operatorët ekonomik kanë detyrimin që ta bëjnë të identifikueshëm pretendimin e tyre mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërbushjen e kriterit/kritereve. Në rastin konkret, K.P.P gjykon se ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës (barra e provës i bie kërkuesit) bazuar në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSh” parashikohet se *“Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*. Sa më sipër, KPP thekson se nuk mjafton vetëm pohimi i operatorit ekonomik ankimues për të vërtetuar pretendimet e tij, e për rrjedhojë, në respekt të parimit të barazisë dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, në mungesë të fakteve dhe provave, ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim gjatë ankimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

III.5.Lidhur me ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga operatori ekonomik ankimues “MB KURTI” sh.p.k. KPP sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: *“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* *“Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.”* *“Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”*. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: *“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”*

III.5.1.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, konstatohet se ankesa e operatorit ekonomik ankimues “MB KURTI” sh.p.k., është pranuar nga autoriteti kontraktor në datë 06.10.2017, referuar aktit administrativ nr.7788/4prot., datë 11.10.2017, trajtim i ankesës së autoritetit kontraktor administruar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nga ana e operatorit ekonomik ankimues, me anë të ankesës të paraqitur pranë KPP protokolluar datë 23.10.2017. Referuar *lex specialis*, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik të ndryshuar”, parashikohet se ankimi administrativ pranë Autoritetit Kontraktor dorëzohet me shkrim *brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.* Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë Autoritetit Kontraktor nis ditën e nesërme të punës pas marrjes dijeni për shkeljen e pretenduar. Në rastin konkret, Komisioni i

Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues nuk e ka ezuaruar ankimin administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 2 të L.P.P.-së, pasi ankimi i dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatorit ekonomik ankimues më datë 06.10.2017 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga *lex specialis*. Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor nis nga dita e nesërme e punës, kur operatori ekonomik ankimues duhet të ishte njoftuar nga autoriteti kontraktor mbi vlerësimin nga ky i fundit dhe përfundon ditën e shtatë. Në rastin konkret, afati maksimal i paraqitjes së ankimit pranë autoritetit kontraktor nga ana e operatorit ekonomik ankimues është datë 05.10.2017. Në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSh” parashikohet se “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

III.5.2.Sa më sipër, KPP gjykon se nuk mjafton vetëm pohimi i operatorit ekonomik ankimues “Kemi paraqitur ankesë me shkrim pranë AK Durrës më datë 04/10/2017” për të vërtetuar datën e dorëzimit të ankesës pranë autoritetit kontraktor, por operatori ekonomik ankimues duhet të kishte paraqitur prova fizike për të vërtetuar pohimin e tij. KPP konstaton se nuk ka provë tjetër për tu referuar mbi datën e dorëzimit të ankesës, përveç shkresës së autoritetit kontraktor mbi shqyrtimin e ankesës dhe për këtë arsye për llogaritjen e afateve, KPP e bën duke filluar nga data që autoriteti kontraktor ka protokolluar ankesën. Për këtë arsye, ankesa e paraqitur prej operatorit ekonomik ankimues “MB KURTI” sh.p.k. është pas përfundimit të afatit të parashikuar nga neni 63 pika 2 të L.P.P.-së, duke mos u legjitimuar *ratione temporis* në dorëzimin e ankesës pranë K.P.P.

III.5.3.Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “MB KURTI” sh.p.k., pranë autoritetit kontraktor, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” që, referuar nenit 23, pikës 3, shkronja “a”, të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ndaj dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.5.4.Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të

vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 dhe 28 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

#### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE ankimues “NELSA” sh.p.k. & “ERDIS” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt “Blerje Ushqimesh”, me nr. REF-24608-08-24-2017, me fond limit 35,333,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 25.09.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “MB KURTI” sh.p.k. për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1571 Protokoli, Datë 09.10.2017 ; Nr. 1606 Protokoli, Datë 23.10.2017

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Zv/Kryetar**  
**Leonard Gremshi**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Anëtar**  
**Kleves Janku**

**Anëtar**  
**Odise Moçka**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**